



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve

Data: 29.05.2023

Nr: 161

Ora: 14:00

VENDIM

PËR MOSPRANIMIN PËR SHQYRTIM TË KËRKESËS ANKIMORE NR. 84, DATË 26.05.2023 TË DEPOZITUAR NGA SUBJEKTI ZGJEDHOR "PARTIA ALEANCA DEMOKRISTIANE E SHQIPËRISË"

Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve në mbledhjen e datës 29.05.2023, me pjesëmarrjen e:

Ilirjan	RUSMALI	-	Relator
Elvin	LAKO	-	Anëtar
Elvis	ÇEFA	-	Anëtar
Koli	BELE	-	Anëtar

Shqyrtoi çështjen me:

ANKUES: Partia "Aleanca Demokristiane e Shqipërisë" përfaqësuar nga z. Zef Bushati

OBJEKT: Kundërshtim i Vendimit të KZAZ & KQZ:

1. Për ndryshimin e Tabelës Përmbledhëse të Rezultateve për Zgjedhjen e Këshillit të Bashkisë KAMËZ në njësitë Kamëz dhe Paskuqan në KZAZ me Nr. 27 dhe 28 sipas rezultatit që do të dalin nga kqyrja e 24 qendrave.
2. Kërkojmë pavlefshmerinë e rezultatit në disa Qendra Votimi si më poshtë: KZAZ nr 27 ne 10 qendra votimi si me poshte vijon 1570/01,

Data: 29.05.2023 Nr: 161
Ora: 14:00



"Për mospranimin për shqyrtim të kërkesës ankimore nr. 84, datë 26.05.2023 të depozituar nga subjekti zgjedhor 'Partia Aleanca Demokristiane e Shqipërisë'"

1571,1571/01, 1656/01,1577/02,1590,1593/01,1599,1599/01,1600, KZAZ ne 28 ne Qendrat 2040/012041/3, 2042/02, 2043, 2045, 2045/03, 2046, 2046/012, 2046/02, 2047/02, 2047/03, 2048/02, 2050/02.

3. Kërkojmë Rivlerësim për ndryshimet e pamotivuara në Tabelën Elektronike të Rezultateve përmbledhëse për Këshillin Bashkiak Kamëz.

BAZË LIGJORE: Nenet 124, 126, 129 dhe 130 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar

Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur,

VËREN:

Subjekti zgjedhor “Partia Aleanca Demokristiane e Shqipërisë” ka depozituar pranë KQZ-së kërkesën ankimore, e cila në respektim të kriterëve të përcaktuara në nenin 127, të Kodit Zgjedhor, është regjistruar në regjistrin e ankimeve zgjedhore, me nr. 84 regj., datë 26.05.2023.

Në seancën e datës 25.05.2023, KAS konstatoi se kjo kërkesë ankimore nuk i plotësonte elementët e formës të parashikuara në nenin 126, pasi është paraqitur me të meta, duke ia qartësuar palës ankimuese se duhet të saktësojë objektin e saj, të përcaktojë bazën ligjore, të paraqesë provat bashkëlidhur, si dhe një përshkrim më të detajuar të fakteve dhe rrethanave konkrete.

Me anë të vendimit nr. 146, datë 25.05.2023, KAS vendosi kthimin e kërkesës ankimore për plotësim të elementeve të formës, me një afat 24 orë.

Në mbledhjen e datës 29.05.2023, ora 14:00, pas relatimit të z. Ilirjan Rusmali u konstatua dhe u pohua nga administrata e KQZ-së se subjekti ankues nuk e kishte ridepozituar kërkesën ankimore të korrigjuar, sipas përcaktimeve të bazuara në Kodin Zgjedhor, që KAS orientoi në seancën e datës 25.05.2023.

Në mbështetje të nenit 17, pika 3, shkronja “b”, të vendimit nr. 03, datë 06.11.2020, të Komisionit Rregullator, “Për mënyrën e funksionimit dhe zhvillimit të seancave të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve” dhe nenit 129 pika 3 shkronja “b” të Kodit Zgjedhor kërkesa ankimore nuk duhet të kalohet për shqyrtim.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenin 129, pika 3, shkronja “b” të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, KAS-i

V E N D O S I:

1. Mospranimin për shqyrtim të kërkesës ankimore nr. 84, datë 26.05.2023, të paraqitur nga subjekti zgjedhor “Partia Aleanca Demokristiane e Shqipërisë”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Bazuar në pikën 1, të nenit 145 të Kodit Zgjedhor mund të bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor Gjyqësor, pranë Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë, brenda 5 (pesë) ditëve nga shpallja e këtij vendimi, sipas përcaktimit të pikës 2 të nenit 152 të tij.

Ilirjan	RUSMALI	-	Relator
Elvin	LAKO	-	Anëtar
Elvis	ÇEFA	-	Anëtar
Koli	BELE	-	Anëtar